



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1904/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI129/20

Parashtrues

Hamdi Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës Rev. nr. 305/2019 të 10 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hamdi Berisha nga Gjilani (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Mustafë Musa, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 305/2019 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 10 qershorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme Rev. nr. 305/2019, të 10 qershorit 2020, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe neni 17 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 gusht 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi.
7. Më 30 shtator 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH 129/20, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin Nr. K.SH. K129/21, përmes të cilit zëvendësoi Kryetaren e mëparshme Arta Rama-Hajrizi në rolin e saj si kryesuese e Kolegjit shqyrtues me gjyqtaren Gresa Caka-Nimani.
13. Më 3 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 19 prill 2001, parashtruesi i kërkesës dhe S.K. në cilësinë e tyre si blerës lidhën kontratën e shitblerjes me shitësin M.H., ku objekt i kësaj kontrate është prona e paluajtshme nr. 2359, ZK Gjilan, nr. i Zonës kadastrale 70403013, nr. i ngastrës kadastrale 2245/0, e cila gjendet në vendin e quajtur “Bashqe”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.17.37 ha, (në tekstin e mëtejme: ngastra e kontestuar).
15. Në një datë të pacaktuar në vitin 2001, Komuna e Gjilanit dhe ndërmarrja e shërbimeve publike Higjiena nga Gjilani ngritën padi në Gjykatën Komunale kundër parashtruesit të kërkesës dhe personave të tjerë, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitjes VR nr. 721/2001 të 23.04.2001 në lidhje me blerjen e ngastrës së kontestuar, duke theksuar se kjo kontratë e shitblerjes është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi ngastra kadastrale e cila është objekt i transferimit ligjor është shpronësuar në vitin 1973 nga Ndërmarrja Publike Komunale „Higjiena”.
16. Më 18 qershor 2004, parashtruesi i kërkesës dhe S.K. parashtruan padi kundër Komunës së Gjilanit dhe Ndërmarrjes Publike Komunale „Higjiena” nga Gjilani, përmes të cilës kerkuan nga gjykata që të paditurit t’ua njohin pronësinë mbi ngastrën e kontestuar.
17. Në lidhje me këto dy padi, Gjykata Komunale në Gjilan mbajti seancën përgatitore dhe kryesore dhe meqë përbërja e gjykatës në këtë çështje kontestimore u ndryshua, gjykata rihapi procedurën e shqyrtimit që nga fillimi, duke i bashkuar të dy rastet, në mënyrë që procedura të kryhej sipas rastit të vjetër të ngritur në Gjykatën Komunale në Gjilan.
18. Më 1 shtator 2011, Gjykata Komunale në Gjilan përmes aktgjykimit [C. nr. 539/2001] aprovoi kërkesëpadinë e Komunës së Gjilanit dhe ndërmarrjes publike komunale „Higjiena”, dhe anuloi kontratën e shitblerjes VR. nr.

721/2001 të 23 prillit 2001, ndërsa refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të S.K. së për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi ngastrën e kontestuar si të pabazuar.

19. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktgjykimit të mësipërm të Gjykatës Komunale në Gjilan, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me pretendimin për shkelje të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 17 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin [AC. nr. 335/11] refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
21. Në një datë të pacaktuar, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 4 korrik 2013, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev. nr. 163/2012, aprovoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, dhe anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe e ktheu rastin në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.
23. Më 6 korrik 2015, Gjykata Themelore në Gjilan në procedurën e përsëritur [Aktgjykimi C. nr. 566/2013] e aprovoi përsëri kërkesën e Komunës së Gjilanit dhe të kompanisë publike komunale "Higjiena" dhe anuloi kontratën e shitblerjes VR. nr. 721/2001 të 23 prillit 2001, ndërsa refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe të S.K. për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi ngastrën e kontestuar si të pabazuar.
24. Sa i përket kërkesëpadisë së Komunës së Gjilanit dhe të kompanisë publike komunale "Higjiena" nga Gjilani, Gjykata Themelore në Gjilan, në aktgjykimin e saj, arsyetoi se *"[...] Në bazë të Kopjes së Planit Urbanistik për Qytetin e Gjilanit, të lëshuar nga Arkivi Ndërkomunal në Gjilan, nr. 70/04 të datës 25.03.2004, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale që atëherë evidentohet me nr. 2245-0 e që tani është objekt i kontestit ishte përfshirë në ekspropriim në mesin e shume ngastrave tjera për nevojat e zgjerimit të "Tregut të Gjellbërt" në Gjilan.*
Në këtë kopje të planit është evidentuar shfrytëzuesi i kësaj ngastre kadastrale para ekspropriimit Mehmedali Hisni nga Dobërqani dhe tjetërsimi i kësaj ngastre në bazë të aktit administrativ në shfrytëzuesin Organizata Komunale për Veprimtari Banesore në Gjilan, dhe kjo mbanë evidencën e vitit 1992 për shfrytëzuesin e ri.
Poashtu fakti se kjo pjesë e ngastrës kadastrale ka qenë e ekspropriuar për nevojat e zgjerimit të "Tregut të Gjellbërt" në Gjilan, vërtetohet edhe nga Aktvendimi nr. 465-14/94 i datës 18.11.1994 të lëshuar nga Kuvendi Komunal në Gjilan, me të cilin aktvendim ngastra kadastrale e atëhershme nr. 2245-0 është përfshirë në interesin shoqëror për nevojat e zgjerimit të "Tregut të Gjellbërt" në Gjilan. [...]

Edhe në bazë të shkresës nr. 318 të datës 18.08.1988 të lëshuar nga Kuvendi Komunal në Gjiilan, vërtetohet fakti se ngastra kontestuese është përfshirë në aktin e ekspropriimit, pasi që siq thuhet në këtë shkresë “Tregu i Gjellbërt” në Gjiilan në sipërfaqe ashtu siq është nuk i plotëson nevojat e qytetarëve të Gjiilanit, dhe për këtë arsye me qëllim të zgjerimit të tij janë përfshirë edhe ngastrat kadastrale 2244/1 dhe 2245. Në bazë të Marrëveshjes mbi kompenzimin të datës 17.01.1975 dhe Aktvendimeve nr. 07 -465-20 të datës 27.02.1973, nr. 07-465-21, nr. 07-465-22, nr. 07-465-23, gjykata konstatoi faktet se të gjitha ngastrat kadastrale që gjenden në kuadër të “Tregut të Gjellbërt” në Gjiilan, ishin ekspropriuar dhe kompenzuar ish pronarëve të paluejtshmërive“..

25. Sa i përket kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore në Gjiilan në aktgjykimin e saj, arsyetoi se “[...] meqë ngastra kadastrale kontestuese është ekspropriuar me vendim komunal si pasuri në interes të përgjithshëm shoqëror, ajo si e tillë është jashtë qarkullimit juridik dhe nuk ka mundur të jetë objekt i kontratës së shitblerjes mes personave fizik tani të paditurëve, pasi që një bartje e tillë e një të drejte është në kundërshtim me vet Ligjin mbi Qarkullimin e Pasurive të paluajtshme”.
26. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore në Gjiilan gjithashtu arsyetoi pretendimet e parashtruesit në lidhje me çështjen e kompensimit për shpronësimin e ngastrës së kontestuar, duke theksuar se “Qështja e kompenzimit të kësaj ngastre kadastrale nuk është kërkuar fare nga të paditurit dhe përfaqësuesi i tyre, prandaj gjykata nuk ka mundur të lëshohet në këtë çështje, pasi do të bënte shkelje të dispozitave ligjore lidhur me tejkalimin e kërkesëpadisë”.
27. Më 13 korrik 2015, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
28. Më 11 qershor 2019, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [AC. nr. 4058/2015] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e shkallës së parë.
29. Më 15 korrik 2019, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
30. Më 10 qershor 2020, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Rev. nr. 305/2019] refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

31. Në këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme arsyetoi se “kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të të paditurve Hamdi Berisha nga Gjilani dhe Selim Kamberi nga Prishtina si blerës dhe Mehmedali Hisni nga Bursa -Republika e Turqisë si shitës, është kontratë e lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe si e tillë është apsolutisht nule, pasi që ngastra kadastrale kontestuese në vitin 1973, është përfshirë me vendim komunal si pasuri me interes të përgjithshëm shoqëror, dhe si e tillë është jashtë qarkullimit juridik, kurse në vitin 1994 de fakto edhe ka kaluar në shfrytëzim tek paditësja ndërmarrja Komunale Publike “Higjiena” në Gjilan.
- Objekti i kontratës mbi shitblerjen përveç se është i pamundur, është edhe i palejuar, lejueshmëria e objektit të kontratës është cilësia e tretë që kërkohet për vlerësimin e kontratës së lidhur. Kjo madje kërkohet shprehimisht në nenin 49 të LMD-së, ku thuhet “Objekti i detyrimit është i palejueshëm në qoftëse është në kundërshtim me, parimet e rregullimit shoqëror të përcaktuar me kushtetutë, me dispozitat e detyrueshme, dhe me normat e moralit”.
- Me dispozitën e nenit 450 par 1 të LMD-së, është përcaktuar se një ndër detyrimet kryesore të shitësit është dorëzimi i sendit të blerësi. Dorëzimi i sendit nënkupton kalimin e pronësisë mbi sendin. Në këtë mënyrë, blerësit i mundësohet pushteti faktik dhe juridik mbi sendin e blerë. I padituri i tretë në cilësinë e shitësit, në rastin konkret nuk ka mundësi që t’ia bart pushtetin faktik dhe juridik mbi parcelën që ka qenë objekt i shitblerjes të paditurit të parë dhe të dytë si blerës, pasi që kjo parcelë në momentin e lidhjes së kontratës nuk ka qenë në pushtetin faktik të shitësit. Prandaj, kontrata mbi shitblerjen e lidhur në mes palëve kontraktuese është nule, në kuptim të nenit të 49 të LMD-së, për arsye se objekti i kontratës për shitblerjen ligjërisht ka qenë i pamundur të realizohet ashtu që blerësve ti dorëzohet në posedim prona që ka qenë objekt i shitblerjes.
- Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se të dy gjykatat drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur e kanë refuzuar kundërpadinë e të paditurve për vërtetimin e pronësisë të parcelës kontestuese, kjo për faktin se, kontrata mbi shitblerjen e lidhur në mes ndërgjyqësve, është nule në bazë të nenit 49 të LMD-së, dhe si e tillë nuk paraqet bazë të vlefshme juridike për njohjen e të drejtës së pronësisë në favor të paditurve. Në këtë kuptim kjo Gjykatë, i refuzoi si të pa bazuara pretendimet në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
32. Në fund, Gjykata Supreme konstatoi se, “Nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182, par 1 e lidhur me nenin 199 të LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, në lëndën Rev. nr. 163/12 të datës 04.07/13, dhe nuk ka vërtetuar faktet vendimtare nëse ngastra kontestuese është ekspropriuar. Pretendimet e këtilla u cilësuan si të pabazuara për arsye se janë në kundërshtim me provat në lëndë dhe arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet tjera në revizion u treguan si të pa suksesshme për të marrë vendim më të favorshëm të paditësve për arsye se përsëriten të dhënat që kanë qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë ku janë dhënë arsye të mjaftueshme që janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimeve të kontestuarra janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si dhe nenin 17 të KEDNJ-së.
34. Sa i përket këtyre shkeljeve, parashtruesi i kërkesës pretendon se *„Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës, nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik dhe pasohet me: shpalljen e interesit publik, pronarëve u dorzohet ekzemplari i aktvendimit për eksproprijim-shpronësim dhe u ofrohet marrëveshja për kompensimin real të paluajtshmërisë, çka nuk është rast edhe në rastin konkret. Për paluajtshmërinë kontestuese asnjëherë nuk është shpallur interesi publik, pronarve nuk iu është dorëzuar asnjëherë aktvendimi për eksproprijim dhe se nuk iu është bërë asnjëherë kompensimi për të njëjtën”*.
Shpallja e interesit të përgjithshëm, në kohën kur pretendohet se është kryer ndaj paluajtshmërisë kontestuese është publikuar edhe në “Gazeten Zyrtare”, çka nuk është rast edhe me paluajtshmërinë kontestuese”.
35. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon zbatim të gabuar të ligjit dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, konkretisht, *„Të tri instancat e gjykatave të rregullta, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materjale, kur kanë zbatuar dispozitën e nenin 111 të LMD-së, që ka të bëjë me pavlefshmërinë relative. Atëherë dihet se cila palë kanë të drejtë të atakojnë kontratën dhe në cilin afat, pra vetëm palët kontraktuese prej 1 viti, gjersa pastaj përmendet edhe dispozita e nenit 103 të LMD-së, sipas së cilës kontrata mund të anulohet nëse është lidhur në kundërshtim me normat imperative, normat e moralit e që do të bënte pavlefshmërinë absolute punën juridike, qka nuk është rast edhe në rastin konkret, kur dihet fakti se paluajtshmëria kontestuese vazhdimisht ka qenë pronë e tani të ndjerit Mehmedali Isni i cili në vitin 1969 në bazë të kontratës private ua kishte shitur të paditurve-kundërpaditësve, të cilët edhe ka lidhur kontratën me shkrim dhe nënshkrimet e tyre i ka vërtetuar gjykata Komunale në Gjiilan në vitin 2001 ”*.
36. Për sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se *„lidhur me eksproprijimin e ngastrës kontestuese të njëjtit kanë prezentuar prova me data të ndryshme edhe atë jo në origjinal por se në kopje, me konstatimin se kinse eksproprijimi i kësaj ngastre është kryer në vitin 1973, pastaj në vitin 1980, pastaj në vitin 1983 apo në vitin 1994, çka le në dilema se diç nuk është në rregull, meqë kjo ngastër nuk ka mundur të ekspoprijohet 4 herë, se e njëjta as një herë nuk ka qenë nën rrethoja të kompleksit të tregut të gjelbërt, në të cilën i padituri-kundërpaditësi Hamdi kishte ngritur një qoshqe - barake montazhe, të cilën i kishin rrënuar organet komunale në vitin 1994, me pretekst se e njëjta është ndërtuar pa leje, por jo se nuk është pronar i kësaj ngastre, të cilat rrethana tejet relevante gjykatat nuk i kanë vlerësuar dhe përfillur fare”*.
37. Në fund, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që t’ia njohë të drejtën e tij pronësore në ngastrën e kontestuar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

[...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj*

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

[...]

Protokolli I i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore

Neni 1

Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[...]

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

[...]

Neni 17

1. *Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët.*
2. *Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij. Thelbësor.*

[...]

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

[...]

Neni 49
Mashtrimi

1. *Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose mban në lajthim me qëllim që me këtë ta shtyj për lidhjen e kontratës, pala tjetër mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor.*

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:
*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
40. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i la plotësuar kriteret e pranueshmërisë siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”.

41. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata përcakton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të autoritetit publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
42. Megjithatë, Gjykata i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
43. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
44. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose

vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*" (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

45. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
46. Gjykata rikujton se kontesti është iniciuar në mes të Komunës së Gjilanit dhe Ndërmarrjes Publike Banesore "Higjiena" nga Gjilani me kërkesën për anulimin e kontratës së shitblerjes të lidhur nga parashtruesi i kërkesës me qëllim të blerjes së ngastrës kontestuese. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtroi kërkesë në gjykatat e rregullta për njohjen e pronësisë së ngastrës kontestuese në bazë të së njëjtës kontratë, anulimi i së cilës u kërkuar nga Komuna e Gjilanit dhe ndërmarrja publike komunale "Higjiena" nga Gjilani, duke pasur parasysh natyrën dhe lidhjen e këtyre dy kërkesave Gjykata Themelore i bashkoi dhe pas procedurës së përsëritur dhe gjykimit, Gjykata Themelore miratoi kërkesën e Komunës së Gjilanit dhe kompanisë publike komunale "Higjiena" nga Gjilani, sepse konkludoi se shitësi, në kohën e lidhjes së kontratës nuk ishte pronari faktik i ngastrës, meqenëse kjo ngastër që nga viti 1994 në të vërtetë, ishte në pronësi të kompanisë publike komunale "Eco-Higjiena". Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata Themelore e refuzoi të njëjtën pasi ngastra kadastrale e kontestuar u shpronësua me vendim komunal si pronë në interesin e përgjithshëm shoqëror, dhe si e tillë është jashtë transaksioneve ligjore dhe nuk mund të jetë objekt i një kontrate shitjeje midis personave fizik, meqenëse një transferim i tillë i një të drejte është në kundërshtim me vet Ligjin për Qarkullim të Pronës së Paluajtshme. Gjykata e Apelit vërtetoi në tërësi vendimin e shkallës së parë, ndërsa përfundimet e këtyre gjykatave, pas parashtrimit të revizionit nga parashtruesi i kërkesës, u pranuan nga Gjykata Supreme, duke theksuar se kontrata e shitblerjes e lidhur midis palëve ndërgjyqëse është e pavlefshme sipas nenit 49 të Ligjit të LMD-së dhe si e tillë nuk përbën një bazë të vlefshme për njohjen e të drejtave pronësore në favor të të paditurve.
47. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit të njëjtat argumente që ai parashtroi në procedurën në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe Gjykatën Supreme, se gjykatat e rregullta janë marrë me këtë çështje, në mënyrë që

Gjykata të shtjellojë më tej në paragrafët e mëposhtëm procedurat në gjykatat e rregullta.

48. Prandaj, thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përmbledhet si më poshtë: (i) pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ -së (i) si dhe nenin 17 të DUDNJ -së; dhe (ii) pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata do t'i shqyrtojë këto pretendime individualisht.

(i) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së*

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thirret në faktin se për shkak të anulimit të kontratës së shitblerjes, atij i është shkelur e drejta e tij në pronë.
50. Gjykata me këtë rast, thekson se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet në praktikën e GJEDNJ-së (shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, i 23 nëntorit 1983; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, i 9 tetorit 2003).
51. Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë që vendimi i kontestuar ka të bëjë me “pronën” e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të jetë “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë “pritshmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejtë pronësore (shih rastet e Gjykatës KI26/18, parashtruesi i kërkesës “*Jugokoka*” Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49; dhe rastin KI156/18, parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52).
52. Në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë “pritje legjitime” atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit e kërkesës janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI156/18, parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 53 dhe shih rastin e GJEDNJ-se *Kopecky kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2004 paragrafi 50).
53. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 305/2020], në bazë të cilit u vërtetuan aktgjykimet e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë dhe me të cilat u anulua kontrata e blerjes së parcelës së kontestuar sepse në kohën e lidhjes së kontratës ajo nuk ishte në pronësi të shitësit, është bërë në mënyrë të paligjshme apo arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit

nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

54. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve (ii) „*mungesë e qartë ose evidente e shkeljes*”, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) *Pretendimet për zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike*

55. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës qëndron në pretendimin se gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme, kanë zbatuar të drejtën materiale në mënyrë arbitrare, përkatësisht dispozitat e neneve 111 dhe 103 të LMD-së, dhe kanë kryer në mënyrë të paligjshme procedurën e shpronësimit, duke rezultuar në shkelje e të drejtave për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.
56. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “*kushtetutshmërisë*” dhe “*ligjshmërisë*” dhe theksoi se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih në këtë kontekst dhe, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
57. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, para 58).
58. Duke u kthyer në rastin konkret, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme, gjyquan në mënyrë logjike, të detajuar dhe të bazuar në ligj rastin e parashtruesit të kërkesës, duke shpjeguar dhe

interpretuar çështjen e shpronësimit dhe kërkesat ligjore që duhen përmbushur për transferimin e të drejtave absolute në pronën e kontestuar. Në këtë rast, gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, refuzuan pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me pronën e kontestuar, që në vetvete nuk përbën shkelje të procedurës së rregullt gjyqësore ose shkelje të së drejtës në pronë. Në veçanti, duke marrë parasysh që argumentet e parashtruesve të kërkesës u dëgjuan dhe u vlerësuan dhe lidhur me të cilat gjykatat e rregullta si dhe Gjykata Supreme kanë dhënë një arsyetim mjaft të justifikuar.

59. Së pari, Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin [C. nr. 566/2013], refuzoi kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, lidhur me çështjen e kompensimit për ngastrën e shpronësuar. Gjykata Themelore arsyetoi se, *“Qështja e kompenzimit të kësaj ngastre kadastrale nuk është kërkuar fare nga të paditurit dhe përfaqësuesi i tyre, prandaj gjykata nuk ka mundur të lëshohet në këtë çështje, pasi do të bënte shkelje të dispozitave ligjore lidhur me tejkalimin e kërkesëpadisë”*.
60. Më tej, Gjykata e Apelit, me aktgjykimin [Ac. nr. 4058/2015], vërtetoi në tërësi aktvendimin [C. nr. 566/2013] të Gjykatës Themelore të 6 korrikut 2015, me arsyetimin se, *“[...] nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në dëm të të paditurve, pasi që siç del nga shkresat e lëndës, për rastin konkret faktet se kjo pjesë e ngastrës kadastrale është eksproprijuar dhe është në shfrytëzim dhe pronësi nga viti 1994 tek paditëset gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar në bazë të të gjitha provave materiale të shtjelluara gjatë shqyrtimeve kryesore”*.
61. Në lidhje me këtë, Gjykata përsëriti gjetjet e Gjykatës Supreme: (i) gjykatat e instancave më të ulëta zbatuan në mënyrë të drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale kur konstatuan se kërkesëpadia e paditësit ishte e pabazuar; (ii) kontrata e shitblerjes e lidhur midis palëve kontraktuese është e pavlefshme, brenda kuptimit të nenit 49 të LMD-së, sepse objekti i kontratës së shitjes ishte ligjërisht i pamundur për t'u realizuar në mënyrë që blerësve t'u dorëzohej posedimi i pronës, që ishte objekt i shitblerjes; (iii) objekti i detyrimit ishte i pamundur sepse një pjesë e ngastrës kadastrale të kontestuar, në vitin 1973 ishte përfshirë me një vendim komunal si pronë me interes të përgjithshëm shoqëror dhe si e tillë ishte jashtë qarkullimit ligjor, objekti i detyrimit nuk mund të ishte realizuar sepse shitësi në kohën e lidhjes së kontratës nuk ishte pronari faktik i ngastrës, pasi kjo ngastër është transferuar de facto në shfrytëzim të paditëses ndërmarrjes publike komunale “Eco-Higjiena” që nga viti 1994.
62. Gjykata vëren se në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim dhe interpretim të ndryshëm të dispozitave ligjore për shpronësim, kompensimin e shpronësimit dhe kushtet për shitjen e pronës së kontestuar, ku Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme refuzuan kërkesat pronësore të parashtruesve të kërkesës.
63. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë

themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rastin KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

64. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës Supreme, të Apelit dhe atë Themelore, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti *Mezotur–Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
65. Prandaj, Gjykata përfundon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm, janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”, dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

66. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së si dhe i) nenin 17 të DUDNJ-së dhe zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, janë pretendime të kategorisë ii) që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”; ndërsa pretendimet e kategorisë i) si pretendime të “*shkallës së katërt*”. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 3 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetaria e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka Nimani